

## AKT THEMELIMI DHE STATUT

I

### SHOQËRISË TREGTARE

#### "FLYFOX" SHPK

Kreu i

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "FLYFOX" SH.P.K, (me poshtë e quajtur "Shoqëria")

Neni 2

Themelimi

Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.

Neni 3

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 25/03/2024, në mbështetje të legjislativit shqipëtar respektivisht Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligji Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit",  
Une, themeluesi, kam krijuar, një shoqëri tregtare me emrin "FLYFOX" SH.P.K, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,

(2) Ortaku themelues i shoqërisë:

-Z.Geraldo Sinaj, i biri i Naimit, i datëlindjes 03.11.1993, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, në adresën: Lagja "28 Nentori", shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e Kartës së Identitetit (ID) me numër personal J31103089W

Neni 4

Objekti

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "FLYFOX" SH.P.K do të ketë objekt të veprimtarisë së saj si më poshtë vijon:

- Ofrimi i shërbimeve logistike, të shpërndarjes së produkteve ushqimore dhe produkteve të tjera tek konsumatorët në Shqipëri.
- Shërbime postare, shërbime pastrimi të përgjithshme, shërbime reklame, shërbim marketingu, këshillimi për marketing, shërbim këshillimi për shitje etj.

---

### AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE

#### "FLYFOX" SHPK

Faqë 1 nga 9

- c. Zhvillimi, prodhimi, import-eksport, blerja, rishtja dhe marketingu i ushqimit, shpërndarjes së produkteve të tjera, dhe shërbimeve logistike lokale në Shqipëri.
- d. Shitje, dhënie me qira mjetesh motorike, dhe mjete të tjera të transportit rrugor.
- e. Shërbime ndërmjetësimi, franchise, përfaqësimi, veprimi si ndërmjetës mes konsumatorëve fundorë dhe bizneseve ose ndërmjet bizneseve (B2B), qoftë kur ata janë restorante, kafene, dyqane të veçantë (p.sh., markete, farmaci, dyqane lulesh, dyqane dhuratash, shitës lokalë të kartave telefonike, shitës pijesh).

Me qëllim përbushjen e objektit të mësipërm, Shoqëria ka të drejtë:

- a. Të lidhë çfarëdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë, entitete private ose publike, vendase ose të huaja organë të administratës shtetërore;
- b. Të themelojë të gjitha lloje te shoqërive ose të marrë pjesë në kompani të huaja apo shqiptare, bashkime shoqërish/joint venture ose biznese të tjera qe kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me atë të Shoqërisë.
- c. Të themelojë degë ose agjenci në Shqipëri ose jashtë saj.
- d. Të kryejë aktivitete tregtare të lidhura me qëllimin e Shoqërisë në Shqipëri ose jashtë territorit shqiptar.
- e. Të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti të lidhur tregtar ose të një lloji tjetër dhe të procedojë me çdo dhe të gjitha mjetet e duhura ligjore ose transaksionet që kontribuon drejtpërdrejt ose indirekt lidhur me qëllimin e Shoqërisë, si dhe të kryejë të gjitha aktivitetet e nevojshme ose të duhura me qëllim përbushjen e qëllimit të aktivitetit të shoqërisë në përputhje me ligjin.

#### **Neni 5 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare “FLYFOX” SH.P.K. është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

#### **Neni 6 Selia**

(1) Selia e Shoqërisë Tregtare “FLYFOX” SH.P.K. është në Tiranë, në adresën: Tiranë, Rr. Kavajës, Hyrja 1, Apartamenti 12, Zona Kadastrale 8220, Nr Pasurie: 7/244-N75, Vol 19, Fq35

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime te komunikimit elektronik është si vijon: [flygroupofcompanies@gmail.com](mailto:flygroupofcompanies@gmail.com)

---

#### **AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

#### **“FLYFOX” SHPK**

Faqë 2 nga 9

**Kreu II  
Kapitali**

**Neni 7  
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestari Shoqërisë Tregtare "FLYFOX" SH.P.K është 100,000 (njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: Geraldo Sinaj zotëruesh i 1 (një) kuote më vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) Lekë që përbën 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributet e mësipërme janë shlyer tërësisht.

**Neni 8  
Zmadhimi dhë zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjësëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin ë tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohën për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 9  
Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshmë ndërmjët ortakëvë, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

---

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**"FLYFOX" SHPK**

Faqë 3 nga 9

**KREU III**  
**ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE**

**Neni 10**  
**Organë Vendim-marrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vëndimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet ë mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhë "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblënë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të vëprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblënë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 11**  
**Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vëndin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet

---

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**"FLYFOX" SHPK**

Faqa 4 nga 9



të gjithë ortakëve, jo më vonë së 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 12 Kuorumi

Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë së 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhë Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë së 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 13 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin osë zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### Neni 14 Përjashtimi nga e drejta e votës

I.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

### AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE

### “FLYFOX” SHPK

Faqë 5 nga 9



- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përcaktimave të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësuës i autorizuar, i autorizuari vlërësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 15 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshmë emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Afat i emërimit, është 2(dy) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Me themelimin e shoqërisë emërohet Administrator Z.Geraldo Sinaj i biri i Naimit, i datëlindjes 03.11.1993, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, në adresën: Rr "28 Nëntori", shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e Kartës së Identitetit (ID) me numër personal J31103089W, që do të qëndrojë në detyre për një afat 2 (dy) vjecar me të drejtë rizgjedhjeje.

### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhë nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë rregjistrimet dhe dërgojë të dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohët në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikavë tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thirresë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

---

### AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE

**"FLYFOX" SHPK**

Faqë 6 nga 9



-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetmë financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivët e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 16** **Përgjegjësitet e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administritimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 ë 18 të ligjit "Për Trëgtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëndis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë më përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ato të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij më profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme më qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Trëgtarët dhë Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet ë mëposhtme:

---

#### **AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

#### **"FLYFOX" SHPK**

Faqa 7 nga 9



- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivët shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte astësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet pësonalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen ë plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti finanziar-ekspertët**

##### **Neni 17 Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 18 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëvë për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 19 Prishja dhë likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;

---

#### **AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

#### **“FLYFOX” SHPK**

Faqë 8 nga 9



- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhë emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër“.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 20 Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### **Neni 21 Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhë dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 22 Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhë të tretëve, në rast se ato nuk zgjidhen me mirëkuptim mes palëve, për zgjidhjen e tyre do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU**

**I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“FLYFOX” SH.P.K**

**GERALDO SINAJ**

*Geraldo Sinaj*

---

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**“FLYFOX” SHPK**

Faqë 9 nga 9